



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016-50012

Më datë 23.08.2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 17, i Ligjit Nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013” dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016” e në zbatim të kërkesës të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim, 01-Nr-104-41989 të datës 31.07.2024, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-së për “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-së për “Zonën Ekonomike” në Duhel

- Me qëllim të ofrimit të vizionit, qëllimit dhe objektivave në procesin e planifikimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirok dhe Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhel, e që duhet të definohen në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, formohet Ekipi Komunal i Planifikimit për PRrH-në “Zonën Industriale në Shirok dhe PRrH-në “Zonën Ekonomike” në Duhel, në këtë përbërje:
 - 1.1 Visar KUÇI-----Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim,
 - 1.2 Doruntina BYTYQI- -----Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim
 - 1.3 Albulena KUÇI -----Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim
 - 1.4 Elona KUÇI -----Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim,
 - 1.5 Florinda ISUFAJ----- Drejtorja për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë
 - 1.6 Driton MALIQAJ-----Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
 - 1.7 Avni BYTYÇI-----Zyra Ligjore
 - 1.8 Emrush BYTYQI-----Drejtorja për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
 - 1.9 Ardita KOLGECI----Drejtorja për Administratë,
 - 1.10 Liridona ASLLANAJ- Drejtorja për Inspektion,
 - 1.11 Agim BYLYKBASHI-Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet,
 - 1.12 Hajrush SUKA-----Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
 - 1.13 Memi GOLLOPANI--Qendra për punë sociale
 - 1.14 Refki GOLLOPANI---Drejtorja për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe
 - 1.15 Atedhe BUZHALA---Drejtorja për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
- Udhëheqëse i Ekipit Komunal për Planifikim për PRrH-në “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-në “Zonën Ekonomike” në Duhel, sipas detyrës zyrtare, emërohet z. **Visar KUÇI**
- Koordinatorë e Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-së “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-së “Zonën Ekonomike” në Duhel, për koordinimin e punëve të Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-në “Zonën Industriale në Shirok dhe PRrH-në “Zonën Ekonomike” dhe kompanisë “INSI” Sh.P.K me seli në Prishtinë, është znj. **Doruntina BYTYQI**.

4. Detyra e Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) është të punojnë në hartimin e PRrH-së për “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-së për “Zonën Ekonomike”, në Duhel në bashkëpunim me kompaninë “INSI” Sh.P.K me seli në Prishtinë, konform Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013” dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.
5. Anëtarët e EKP-së obligohen që të ofrojnë përkrahjen e tyre profesionale dhe intelektuale nga fushë-veprimtaria e drejtorisë përkatëse. Në moment kur kërkohen informata dhe propozime profesionale nga lëmi që ofron drejtoria përkatëse, anëtari përfaqësues i drejtorisë mund të kërkojë nga zyrtarët kompetent brenda drejtorisë por edhe jashtë saj siç janë: intelektualë, ekspertet të pavarur, shoqata të ndryshme e të ngjashme (në këto raste duhet të mbahet evidenca e ofruesit të informatës respektivisht idesë dhe propozimit në dosje).
6. EKP-ja obligohet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, shoqatat, grupet e interesit, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të Komunës e të ngjashme, në kuptim të gjithëpërfshirës dhe rritjes së cilësisë të PRrH-së për “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-së për “Zonën Ekonomike” në Duhel.
7. Ndërsa mandati i EKP përfundon me miratimin e PRrH-në “Zonën Industriale” në Shirok dhe PRrH-në “Zonën Ekonomike” në Duhel nga Kuvendi të Komunës në Suharekë.
8. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ

I dorëzohet:
DUP-së
Anëtarëve të ekipit,
Në dosje,